



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.04, datë 16. 02. 2017

Për

“Shqyrtimin e ankimit administrativ të sipërmarrësit Albtelecom Sh.a., me objekt “Ndryshimin e Vendimit të Këshillit Drejtues Nr. 2701, datë 22. 12. 2016 për “Miratimin e Dokumentit: Analizë e Tregjeve me shumicë të aksesit broadband në Internet dhe Linjave me Qira – Dokumenti përfundimtar””

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Zj Anila	Denaj	Anëtar
4. Zj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Zj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj. Sara Reçi, në mbledhjen e datës 16.02.2017, në mbështetje të nenit 114 dhe nenit 115 në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi sipas procedurës së përcaktuar në nenin 136 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, çështjen me objekt:

- Ankimi administrativ i sipërmarrësit Albtelecom Sh.a., me objekt “Ndryshimin e Vendimit të Këshillit Drejtues Nr. 2701, datë 22. 12. 2016 për “Miratimin e Dokumentit: Analizë e Tregjeve me shumicë të aksesit broadband në Internet dhe Linjave me Qira – Dokumenti përfundimtar”

BAZA LIGJORE:

1. Shkronja ç) e nenit 8, neni 31 e vijues të ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);
2. Neni 130 e vijues të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (**ligji nr. 44/2015**);
3. Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP ;

4. Rregullore Nr. 9, datë 17.07.2009 “Për Analizën e Tregut”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP, nr. 17. 07. 2009, të ndryshuar (**Rregullore nr. 9**).

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Ankimi administrativ i sipërmarrësit Albtelecom Sh.a., me objekt “Ndryshimin e Vendimit të Këshillit Drejtues Nr. 2701, datë 22. 12. 2016 për “*Miratimin e Dokumentit: Analizë e Tregjeve me shumicë të aksesit broadband në Internet dhe Linjave me Qira – Dokumenti përfundimtar*”, (**Ankimi administrativ**), depozituar në AKEP me shkresë nr. 423, datë 20.01.2017, (referencë AKEP nr.prot 372, datë 23.01.2017);
2. Relacionin shpjegues mbi trajtimin e çështjes të paraqitur nga struktura e ngarkuar për këtë qëllim, Drejtoria e Rregullimit Ekonomik dhe Statistikave - DRRES, (**Relacioni**);
3. Projekt-Aktin vendimmarrës të Këshillit Drejtues në përfundim të shqyrtimit të Ankimit, të rekomanduar nga struktura e ngarkuar për trajtimin e çështjes, DRRES;

si dhe:

- konsiderimi i shpjegimeve të dhëna nga relatori i çështjes dhe diskutimeve në mbledhje;
- fakteve të paraqitura dhe analizës së tyre referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

I. Në aspektin procedural:

1. Akti administrativ Vendim i Këshillit Drejtues Nr. 2701, datë 22. 12. 2016 për “*Miratimin e Dokumentit: Analizë e Tregjeve me shumicë të aksesit broadband në Internet dhe Linjave me Qira – Dokumenti përfundimtar*” (**VKD nr. 2701**) është ankimuar nga sipërmarrësi Albtelecom Sh.a., bazuar në të drejtën dhe procedurën e përcaktuar në pikën 1 të nenit 130 të ligjit nr. 44/2015 dhe dispozitat vijuese të tij;
2. Përmbajtja e Ankimit administrativ është në përputhje me përcaktimet e parashikuara në nenin 131 të ligjit nr. 44/2015 dhe është depozituar brenda afatit ligjor të përcaktuar në pikën 1 të nenit 132 të këtij ligji, pranë organit administrativ të cilit i drejtohet ankimi sipas shkronjës a) të nenit 134/1 të ligjit nr. 44/2015.
3. Ankimi administrativ gjendet në kushtet e pranimit të ankimit sipas nenit 135 të ligjit nr. 44/2015.
4. Këshilli Drejtues i AKEP, për shqyrtimin e ankimit administrativ po zbaton procedurën e përcaktuar në nenin 136 të ligjit nr. 44/2015.

II. Në aspektin e trajtimit në thelb të çështjes:

1. Ankimuesi në ankimin administrativ parashtron kërkesën për ndryshimin e :
 - VKD nr.2701 për “*Miratimin e Dokumentit: Analizë e tregjeve me shumicë të aksesit aksesit broadband në Internet dhe Linjave me Qira – Dokumenti përfundimtar*”

duke kërkuar nga AKEP ndryshimin e përmbajtjes së dokumentit “*Analizë e tregjeve me shumicë të aksesit aksesit broadband në Internet dhe Linjave me Qira – Dokumenti përfundimtar*” (**Analiza e tregut**) për mos përcaktimin me FNT të Albtelecom sh.a në tregun me shumicë të aksesit me cilësi të lartë në vendodhje fikse (WHQA) dhe mos vendosjen e detyrimeve përkatëse.

2. Pretendimet dhe kërkesat kryesore të ankimesit Albtelecom për ndryshimin e vendimit të cituar janë si më poshtë:

- Albtelecom në akimimin e tij kërkon të merren parasysh argumentat e tij të sjella gjatë periudhës së këshillimit të dokumentit të analizës së tregut, ku ndër të tjera, përmend si fakt se në komentet e operatoreve të tjerë nuk ka argumenta relevante mbi përmbushjen e kriterëve FNT të Albtelecom. AKEP në qëndrimet e tij nuk ka paraqitur argumente që të rrëzojë pretendimet e Albtelecom.

- Tregu i pakices i shërbimeve të konektivitetit të biznesit funksionon në konkurrencë të plotë, numri i operatorëve që furnizohen nga shërbimet me shumicë të Albtelecom vjen në rritje dhe janë po këta operatorë që iu ofrojnë konektivitet bizneseve, çka tregon për tarifa mjaft të favorshme dhe pozitive të dobëta në tregun me pakicë. Pavaresisht reduktimit të tarifave për linja me qira me iniciative të Albtelecom, interesi për këtë shërbim, në kapacitetet 2, 34, 155 Mb/s, ka qënë i ulët.

- Nisur nga zhvillimet në treg, si dhe treguesit zyrtarë të të dhënave, Albtelecom gjykon se nuk përmbush statusin me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) në këtë treg. Gjithashtu si argument shtesë konsideron edhe faktin që në treg nuk ka pasur mosmarrveshje nga ndonjë operator apo refuzime nga ana e Albtelecom. Si pasojë e kësaj në treg nuk ka kufizime apo mundësi kontrolli të tregut nga Albtelecom kundrejt operatorëve të tjerë.

- Për të shprehur mosdakordësinë me gjetjet e AKEP, Albtelecom ka marrë parasysh pjesët e tregut, duke referuar të dhëna nga dokumenti i analizës nga ku rezulton se ka pasur një reduktim me rreth 25% të pjesëve në treg në numrin e linjave me qera me shumicë duke marrë si bazë krahasimi vitin 2011, ndërkohë që për kapacite bën një analogji me numrin e linjave. Më tej Albtelecom argumenton se ky reduktim është i lidhur me vendimet e Albtelecom për të ulur tarifën me shumicë. Argument tjetër që sjell Albtelecom është edhe reduktimi i të ardhurave nga linjat me qira/kapacitetet e ofruara operatorëve të tjerë.

- Përsa i takon pengesa në hyrje dhe konkurrenca efektive në treg, Albtelecom vlerëson se nuk ka pengesa të pakalueshme në aspektin ligjor dhe rregullator. Në treg sipas tij ka më shumë se një operator që ka rrjet *backbone* kombëtar apo rrjet *core* të zhvilluar në dimensionet e Albtelecom. Avancimet e teknologjisë kanë zbehur avantazhin e të qenit lojtari i parë në treg dhe përfitimit nga ekonomitë e shkallës dhe densitetit, e cila duket në reduktimin e pjesëve të tregut dhe të të ardhurave nga ky shërbim. Gjithashtu avancimet e teknologjisë (4G/3G) dhe mosprezenca e plotë e Albtelecom në tere territorin e vendit, lejojnë hyrjen në treg edhe të ofruesve të tjerë.

- Një tjetër faktor për mos vlerësimin me status FNT sipas Albtelecom është dhe fuqia kundërvepruese e blerësit, që me prezencën e ofruesve të rinj dhe mundësive për përdorimin e teknologjisë 3G/4G, ka rritur presionin në negociatat e mundshme ndaj Albtelecom.

3. AKEP pasi e ka gjetur ligjërish të pranueshëm ankimin, lidhur me pretendimet dhe aryetimin e ankimesit gjykon si më poshtë vijon:

a. AKEP në dokumentin e analizës së tregut të miratuar me Vendimin nr. 2701 ka vlerësuar dhe ka gjykuar se tregu me shumicë i aksesit me cilesi të lartë në vendodhje mundeson disponueshmeri të garantuar dhe shërbime me cilesi te larte, menaxhim me cilesi te larte të rrjetit, perfishire backhau si dhe akses ne rrjet ne pikat qe i duhen biznesit dhe jo perdoruesve te tregut masiv. Ky treg përfshin produktet që janë dizenuar drejt kerkesave specifike që mund të plotësojnë nevojat përdoruesve të biznesit sipas kapaciteteve/cilësisë dhe vendndodhjes së përdoruesve të biznesit. Këto shërbime janë tipike e sipërmarrësve që kerkojnë cilësi të lartë, brez të gjërë në komunikim pa kufizime teknike (limited contention), IP telefoni, data center dhe back up, suport teknik shtesë, kohë të shkurtër riparimi të difekteve, telefoni celulare për punonjësit, kapacitet për të përballuar të dhëna të pakushtëzuara (uncontended data) midis vendodhjes së qendrave ku janë lokalizuar godinat etj. Shume prej tyre mund të kenë kërkesa edhe për shërbime të shtuara si psh. virtual private *networks*. Këto shërbime janë tipikë të ofruara nga lidhje të realizuara nga linjat me qira ose nga platforma me bazë bakër ose nga platformat fibër, me ndërfaqe tradicionale dhe/ose Ethernet.

b. Në dokumnetin e Anlizës së tregut AKEP ka paraqitur argumentat kryesore në lidhje me përcaktimin e Altelecom me FNT për tregun ËHQA, edhe pasi ka marrë komentet e palëve të tjera të interesuara, të cilat kanë mbështetur propozimin e AKEP për FNT të Altelecom në këtë treg.

c. Megjithë kufizimet historike të rrjetit fiks të Altelecom për mbulim në zona të caktuara gjeografike, Altelecom është i vetmi operator me prezencë rrjeti fiks në shumicën e qyteteve dhe zonave të biznesit, dhe kjo prezencë nuk mund të replikohet lehtësisht nga operatorë të tjerë. Migrimi në NGN/NGA ka rritur mundësitë e Altelecom për ofrim të produketve në nivel me shumicë që i sshërbejne tregut me pakicë të WHQA për segmentin e biznesit. Megjithë rënien e pjesëve të tregut në nivel me shumicë, Altelecom ka pjese tregu në nivel rreth 50% për numrin e operatorëve që i ofron kapacitetet me qira kombëtare (95% për ndërkombëtare) dhe rreth 60% sipas kapaciteteve të dhëna me qira . Në lidhje me tregun më pakicë të *high-quality*, operatori incumbent i rrjetit fiks do të jetë edhe më pak i detyruar, për faktin së shërbimet e ofruara nga platformat alternative nuk janë në gjendje të konkurojnë në nivel pakice dhe të ofrojnë produkte me karakteristika si kapacite i dedikuar dhe diapazon frekuence simetrike. Mungesa e rregullimit ne tregun me shumicë që furnizon këtë treg, do të kushtezonte akses-kerkuesit duke mos qënë në gjendje të replikojne oferta e tyre në tregun me pakicë me ato të Altelecom. Alternativat e tyre për të ofruar në tregun me pakicë do të mbeshteteshin në dy mundesi, ose të shesin me shtenjtë ose të ofrojne një produkt më cilësi që nuk i përmbush cilesitë e larta të kerkuara sic e permendëm më sipër.

d. Pavaresisht edhe zhvillimit të teknologjive të tjera, të cilat po zhvillohen si LTE, ato nuk janë ne atë fazë sa të kushtëzojnë rrjetin dhe infrastrukturën kombëtare të rrjetit fiks të Altelecom, bazuar në fibër, pasi nuk janë aktualisht të aftë për të ushtruar presion të mjaftueshëm konkurrues ndaj rrjetit fiks të Albetelcom si dhe të ofrojnë kapacitete të larta transmetimi në nivel me shumicë për operatorë të tjerë, me cilësisne dhe karakteristikat e kërkuara në nivelin me pakicë. Argumenta më të detajuara për këtë aspekt janë dhënë me hollësisht në dokumentin e analizës së tregut si dhe në rekomandimin e KE për tregjet përkatës të vitit 2014, të cilit i është referuar AKEP.

4. Faktet e paraqitura nga ankimesi dhe arsyetimi në mbështetje të pretendimeve dhe kërkesave të parashtruara janë të njejta me ato të paraqitura gjatë procesit të Këshillimit

publik dhe nuk përmbajnë fakte apo argumenta të reja ligjore të cilat do të mund të çonin AKEP në pranimin e kërkesës së tij.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Në mbështetje të procedurës së përcaktuar në nenin 136 të ligjit nr. 44/2015, dhe në rrespektim të afatit të përcaktuar në nenin 140 të këtij ligji, pasi e gjen aktin administrativ VKD nr. 2701, dhe konkluzionet e Analizës së tregut në përputhje me përcaktimet ligjore të parashikuara në nenin 33 të ligjit nr. 9918 si dhe Rregullore Nr. 9;

V E N D O S:

1. Mospranimin e kërkesës së parashtruar në ankimin administrativ nga sipërmarrësi Albtelecom sh.a., të depozituar me shkresën nr.423, datë 20.01.2017, (referencë AKEP nr.prot 372, datë 23.01.2017) dhe lënien në fuqi të Vendimit të Keshillit Drejtues të AKEP me nr. 2701, datë 22.12.2016, për *“Miratimin e Dokumentit: Analizë e tregjeve me shumicë të aksesit aksesit broadband në Internet dhe Linjave me Qira – Dokumenti përfundimtar”*
2. Të njoftohet sipërmarrësi Albtelecom sh.a. sipas nenit 147 e vijues të ligjit nr. 44/2015 për veprimin administrativ dhe vendimin e AKEP lidhur me ankimin administrativ.
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al
4. Ankimuesi, kundër këtij vendimi mund ti drejtohet Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë sipas procedurës dhe afatit të përcaktuar në ligjin nr. 49/2012 *“Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*.

Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. Alban KARAPICI
2. Anila DENAJ
3. Ketrin TOPÇIU
4. Klarina ALLUSHI